



Nr. 118 Prot. Tiranë, më 7.07.2021

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

**AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS
DHE**

KOMITETIT OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR

**“PËR PROMOVIMIN, NXITJEN DHE ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE
SPORTIVE TË PJESËTARËVE TË DIASPORËS, ME SYNIM RUAJTJEN E
TRADITAVE SPORTIVE KOMBËTARE KULTURORE, SI DHE
PROMOVIMIN E SHTRIRJES SË TYRE”.**



PREAMBUL

Agjencia Kombëtare e Diasporës (**AKD**) dhe Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (**KOKSH**) (në vijim referuar individualisht si "Palë") në vlerësim të qëllimeve të përbashkëta për të nxitur promovimin e sportit shqiptar në vendet pritëse të komuniteteve shqiptare në diasporë;

Duke vlerësuar rëndësinë e sportit shqiptar si pjesë e identitetit kombëtar shqiptar, të cilat përfaqësojnë kombin shqiptar në aktivitete sportive ndërkombëtare;

Në zbatim të Ligjit Nr.16/2018 "Për diasporën", Ligjit Nr.79/2017 "Për sportin", i ndryshuar:

DUKE PASUR PARASYSH se Agjencia Kombëtare e Diasporës ka për detyrë të bashkëpunoj dhe koordinojë aktivitetet me institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit, për përmirësimin e pozitës së diasporës shqiptare;

DUKE PASUR PARASYSH se Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, është organizatë jo shtetërore e vendosur në misionin e tij për zhvillimin, promovimin dhe mbrojtjen e Lëvizjes Olimpikë në Shqipëri, në përputhje me Kartën Olimpikë;

Duke shprehur vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimeve të kësaj marrëveshjeje;

PALËT KANË RËNË DAKORD SI MË POSHTË:



Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje, është krijimi i urave të bashkëpunimit, midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, me qëllim promovimin, nxitjen dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive të pjesëtarëve të diasporës, ruajtjen e traditave sportive kombëtare kulturore, si dhe promovimin e shtrirjes së tyre.
2. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje do të interpretohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2

Parimet e përgjithshme të bashkëpunimit

1. Palët do të mbështesin dhe zhvillojnë bashkëpunimin në fushën e diasporës mbi parimet e barazisë dhe përfitimit reciprok.
2. Palët, në bashkëpunim të ngushtë me njëra-tjetrën, brenda mandatëve të tyre përkatës dhe në varësi të burimeve në dispozicion, do të zhvillojnë konsultime për të gjitha çështjet me interes të përbashkët. Për këtë qëllim, Palët do të shqyrtojnë kuadrin e duhur për këto konsultime kurdo që të jetë e nevojshme.
3. Palët bien dakord për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta, me qëllim forcimin e bashkëpunimit dhe realizimin e interesave të përbashkëta, sa i takon promovimit të aktiviteteve të sportistëve shqiptarë të diasporës.
4. Palët në përputhje me instrumente përbërëse dhe vendimet e organeve kompetente dhe do t'u përgjigjen kërkesave për bashkëpunim, në përputhje me procedurat që bien dakord për t'u ndjekur reciprokisht.
5. Agjencia Kombëtare për Diasporën do të marrë përsipër ofrimin e ndihmës për organizimin dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje.



Neni 3

Fushat e bashkëpunimit

1. Palët, brenda mandatëve të tyre përkatëse dhe në varësi të disponueshmërisë së burimeve, bien dakord të përkrahin, nxisin dhe zhvillojnë aktivitete sportive të pjesëtarëve të diasporës, me synim ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit, të trashëgimisë kulturore, si dhe promovimin e shtrirjes së tyre.
2. Palët angazhohen në ngritjen e Këshillit Koordinues të Sportit në Diasporë. Anëtarët e tij do të jenë sportistë të cilët gjatë karrierës së tyre kanë dhënë kontribut të çmuar në promovimin dhe zhvillimin e disiplinave të ndryshme të sportit shqiptar. Proçedurat dhe rregullat mbi të cilat do të krijohet Këshilli, do të bazohen në një rregullore të veçantë të miratuar nga palët.
3. Palët angazhohen në hartimin e nismave të përbashkëta të projekteve sportive dhe bashkëpunojnë në evidentimin dhe përgatitjen e sportistëve shqiptarë të diasporës dhe të sigurojnë pjesëmarrjen e tyre në lojrat olimpike dhe të gjitha lojrat rajonale, kontinentale, ndërkontinentale, nën kujdesin e KOKSH-it.
4. Palët mbështesin promovimin e sportistëve pjesëtarë të diasporës në planin social gjatë dhe pas karrierës së tyre sportive, ndihmojnë në përmirësimin e infrastrukturës dhe të pajisjeve të nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve fizike e sportive, të pjesëtarëve të diasporës.
5. Palët do të inkurajojnë shkëmbimin e eksperiencave dhe projekteve për promovimin e sportit shqiptar në diasporë.
6. Palët angazhohen të zhvillojnë aktivitete vjetore mbi vlerat e sportit shqiptar në diasporë, me qëllim promovimin dhe zhvillimin e disiplinave të ndryshme të sportit shqiptar në diasporë, mbi bazën e programeve vjetore të miratuara nga palët.
7. Palët bashkëpunojnë në krijimin e bazës së përbashkët për planet, programin dhe gatishmërinë, për të mbajtur kontakte të rregullta dhe për të zhvilluar një bashkëpunim praktik në çështjet që kanë të bëjnë me sportin, dhe përfshirjen në këtë fushë të pjesëtarëve të diasporës.

Neni 4



Zbatimi i marrëveshjes

1. Palët do të marrin masat e duhura për të siguruar bashkëpunimin dhe ndërlidhjen efektive ndërmjet tyre, sa i takon bashkëpunimit në fushën e sportit, veçanërisht në vendet ku përfaqësohen të dyja palët.
2. Drejtori Ekzekutiv i AKD dhe Presidenti i Komitetit Ekzekutiv i KOKSH do të konsultohen rregullisht me njëri-tjetrin, për çështjet që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje.

Neni 5

Marrëveshje shtesë

Agjencia Kombetare e Diasporës dhe Presidenti i Komitetit Ekzekutiv i KOKSH, mund të aplikojnë për lidhjen e marrëveshjeve të veçanta shtesë, me qëllim bashkëpunimin dhe koordinimin, në bazë të vullnetit të palëve.

Neni 6

Konfidencialiteti

1. Gjithë informacioni, duke përfshirë informacionin personal që përmbahet nga Palët në lidhje me këtë Marrëveshje, trajtohet si konfidencial. Asnjë informacion personal nuk do t'i komunikohet ndonjë pale të tretë pa miratimin paraprak me shkrim të palës së interesuar.
2. Palët duhet të respektojnë Parimet e Mbrojtjes së të Dhënave të KOKSH në rast se ata mbledhin, marrin, përdorin, transferojnë ose ruajnë të dhëna personale gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.
3. Pala nuk do të përdorë logot e Palës tjetër dhe /ose të Donatorit për aktivitete të përbashkëta pa marrëveshje paraprake me Palën dhe / ose Donatorin përkatës.
4. Detyrimet e parashikuara në këtë nen mbeten në fuqi edhe pas përfundimit të afatit të kësaj Marrëveshjeje.



Neni 7

Zgjidhja e konflikteve

1. Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim apo pretendim që rrjedh nga/ose në lidhje me këtë Marrëveshje, apo rastet e shkeljes, ndërprerjes apo pavlefshmërisë së saj, do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet negocimit mes Palëve.
2. Në rast se mosmarrëveshja, kundërshtimi apo pretendimi nuk është zgjidhur me negociata brenda 3 (tre) muajsh nga marrja e njoftimit nga njëra palë për ekzistencën e një mosmarrëveshjeje, kundërshtimi ose pretendimi të tillë, secila Palë mund të kërkojë që mosmarrëveshja ose kërkesa të zgjidhet pranë organëve kompetente.

Neni 8

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja

1. Memorandumi hyn në fuqi, në ditën e nënshkrimit, nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve.
2. Memorandumi lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
3. Memorandumi nënshkruhet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku secilës i vihet në dispozicion një kopje autentike.

Nënshkruar në Tiranë, në 07.07.2021

**KOMITETI OLIMPIK
KOMBËTAR SHQIPTAR
PRESIDENT I KOMITETIT
FIDEL YLLI**

**AGJENCIA
KOMBËTARE E DIASPORËS
DREJTOR EKZEKUTIV
SONILA HYSI**